



# PROJEKTI I ZBATIMIT TË HEC-it BREGU MADH NË PËRROIN E FSHATIT ZALOSHNJES – BASHKIA SKRAPAR

## VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

## PERMBAJTTA

### 1. HYRIE

### 2. KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

- 2.1 Politika
- 2.2 Baza Ligjore

### 3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- 3.1 Pozicioni gjeografik
- 3.2 Statusi i zones se studuar dhe objektivi i projektit
- 3.3 Karakteristikat klimaterike
- 3.4 Karakteristikat hidrografike
- 3.5 Rregjim hidrologjik, rrjedhja ujore
- 3.6 Relievi dhe geomorfologjia
- 3.7 Kushtet gjeologjiko - inzhinierike te zones
- 3.8 Kushtet gjeologjiko - inzhinierike te veprave hidroteknike
- 3.9 Pershkrimi i veprave hidroteknike
- 3.10 Lidhja e hidrocentralit me rrjetin energjiko
- 3.11 Infrastruktura rrugore e zones dhe rruges ndihmese

### 4. TREGUESIT ENERGJIJIKE TE PROJEKTIT DHE KOSTOJA E PROJEKTIT

### 5. EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ

- 5.1 Statusi i zones ne studim
- 5.2 Variantet e zhvillimit ne perspektive
- 5.3 Mendimi i Komunitetit
- 5.4 Planet e zhvillimit urban te zones
- 5.5 Ekusistemet, habitatet dhe pesazhi egzistues
- 5.6 Trashegimia arkitektonike dhe historike

### 6. METODIKA E VLERESIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

- 6.1 Objektivat dhe qellimi i VNM-se
- 6.2 Metodika e kryerjes se VNM-se
- 6.3 Identifikimi i ndikimeve ne mjedis nga zbatimi i projektit



## 7. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE DHE VLERESIMI I SITUATES

- 7.1 Ndikimet ne mjedis gjate ndertimit te veprave te marries se ujit dhe godines IIEC-it
- 7.2 Ndikimet ne mjedis gjate pregatitjes se veprave te marries dhe transmetimit te ujit per ne hidrocentral
- 7.3 Ndikimet ne mjedis gjate largimit te materialeve qe du te largohen nga kanaler, tunelet, linjat e shtrirjes se tubacioneve, etj
- 7.4 Ndikimet ne mjedis si rezultat i shpelles se materialeve te ndryshme per ndertimin e veprave hidroteknike te hidrocentralit
- 7.5 Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese
- 7.6 Zhumat
- 7.7 Ndikimet ne ujrat siperfaqesore
- 7.8 Ndikimet ne ujrat nentokesore

## 8. PLANI I ZBUTJES SE NDIKIMEVE NEGATIVE & REHABILITIMIT

- 8.1 Perdorimi tokes
- 8.2 Ndikimi tek njerzoret, ndertesat dhe objektet e udertuara nga njerzit
- 8.3 Ndikimet e hidrocentralit mbi trashigimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra te tjera njerzore
- 8.4 Ujha e intensitetit te erozionit dhe zbutja e ndryshimeve te topografise

## 9. NDIKIMI NE FLORE, FAUNE DHE GJEOLOGJINE

- 9.1 Bimet e ujit
- 9.2 Flora dhe Fauna
- 9.3 Iluminja dhe demtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike, problemi mjedisit gjeologjik

## 10. NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDISIN PERRETI

- 10.1 Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise se zones, tokes, etj.
- 10.2 Ndikimet e projektit ne modelin drenazhuar te zones
- 10.3 Ne cilesine dhe sasi te tokes
- 10.4 Ndikimet ne uje
- 10.5 Ndikimet e ndoxesve dhe rrethjeve ne cilesine e ujit
- 10.6 Ndikimet ne ajer
- 10.7 Ndikimi ne klime
- 10.8 Aromat sulfures
- 10.9 Ndikime te tjera klimatike
- 10.10 Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare, qe shoqerujne projektin
- 10.11 Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese e te propozuara



## **11. MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTTI**

- 11.1 Organizimi
- 11.2 Masat e sigurimit teknik ne pune
- 11.3 Mbrojtja e mjedisit
- 11.4 Masat e mara per zbutjen e rrezikut ne mjedis dhe shendet

## **12. RREZIKU NE MJEDIS I LINJES SE TRANSMETIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE TE PRODHUAR DHE MASAT ZBUTESE TE TYRE**

- 12.1 Ndikimet ne mjedis gjate fazes se operimit
- 12.2 Rreumat Endogjene dhe Rrisku i tyre
- 12.3 Efektet biologjike te fushave elektromagnetike
- 12.4 Standartet dhe Rekomandimet Nderkombetare

## **13. MATRICAT PERMBLEDHISE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS**

- 13.1 Matrica e ndikimeve ne mjedis
- 13.2 Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit.

## **14. ASPEKTET NEGATIVE DHE POZITIVE TE NDIKIMIT NE MJEDIS**

- 14.1 Efektet negative
- 14.2 Efektet pozitive

## **15. PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE PROJEKTTI**

- 15.1 Plani i monitorimit
- 15.2 Programi i monitorimit
- 15.3 Plani i monitorimit gjate operimit.

## **16. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**





## I. HYRJE

Rajoni i Shqipërisë Jug-Lindore, ku bën pjesë hidrocentrali "Bregu i Madh", është hapësirë e rëndësishme e parë nga vlerat ujore që paraqet vendi ynë.

Shqipëria ka nënshkruar dhe është zbatues e rregullt e një numri Konventash Ndërkombëtare (Barcelona, Ramsari, Konventa e Biodiversitetit, etj), dhe tashtmë ka një paketë të plotë ligjore për masat mbrojtëse të mjedisit dhe vlerësimit të impaktit ambjental të veprimtarive, shërbimeve apo udhëtimeve në mjedisin veprues.

Ky kuadër ligjor dhe angazhimet ndërkombëtare në fushën e mjedisit, shprejnë shumë detyra ndaj institucioneve për të zbatuar një sistem sa më efektiv për administrimin e ujtrave, jo vetëm në drejtun të zgjidhjes së problemit për prodhimin e energjisë elektrike por dhe zbatimin e përgjegjësive të mjedhura nga këto marrëveshje. Vendi ynë duke qënë anëtar i një numri konventash, detyrohet të zbatojë një sistem sa më efektiv ekonomik, social-mjedisor, për rregullimin e territorit, sidomos në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme mjedisore.

Në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të një vendi, gjithnjë në përputhje me parimin universal të zhvillimit të qëndrueshëm, marrin rëndësi të veçantë gjetja e rrugëve dhe teknologjive më efektive, si për shfrytëzimin sa më racional të pasurive natyrore, ashtu edhe për kontrollin cilësor dhe sasior të ndikimit mbi mjedis dhe sidomos në rrjedhat ujore.

Prodhimi i lëndëve djegëse ka qënë një faktor kryesor i ndotjes së mjedisit në vendin tonë. Në përputhje me Artikullin 4, në kuadrin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimaterike (Protokolli i Kiotos) thahet se: "Të gjitha palët, nën përgjegjësi të tyre, prioritetave specifike kombëtare e rajonale", duhet të:


**"Zhvillojnë, Rifreskojnë periodikisht, Publikojnë dhe të bejnë të gatëshme për Konferencen e Palëve, në përputhje me Artikullin 12, inventarin kombëtar të emetimeve antropogjenike nga burimet dhe absorbimet për të gjitha gazët që shkaktojnë efektin serrë"**.

Pjesa e parë e Dokumentit të Komunikimit të Parë Kombëtar për Ndryshimet Klimatike llogarit emetimet dhe absorbimet e gazeve me efekt serrë nga të gjithë sektorët ekonomik të vendit për vitin 1994. Me qëllim nxjerrjen e emetimeve diuamike të GHG<sub>1</sub> dhe absorbimet, llogaritjet për periudhën (1990-1994) (përveç vitit bazë) janë hërë veçën për sektorin e energjitik. Inventari i gazeve serë është i pari i llojit të tij për Shqipërinë, i cili është zhvilluar në kuadrin e projektit të financuar nga GEF.

**"Mundësimi i Shqipërisë për të përgatitur Komunikimin e Parë Kombëtar në përgjigje të Anëtaresimit në UNFCCC"**. Në përputhje me Metodikën e IPCC-së, Inventari Shqiptar është llogaritur për gjashtë sektorë kryesore:

Energjitike & Transport, Proceset Industriale, Solvente, Bujqësi, Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjeve, si dhe Mbetjet Urbane & Industriale. Inventari Shqiptar i GHG përfaqeson të dhënat për tre gaze të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në efektin serrë:

Dioksidi i Karbonit, Metani dhe Oksidi i Azocit. Figurat tregojnë emetimet totale të gazit serë me të rëndësishem CO<sub>2</sub>, (duke përfshirë drutë e zjarrit në sektorin pyjor për rastin e parë (fig.1) dhe duke i përfshirë në sektorin energjetik për rastin e dytë (fig.2). Pa përfshirjen e drutëve të zjarrit, emetimet nga sektori i energjitikës janë 2902.94 (1000 ton) dhe duke i përfshirë ato në sektorin energjetik mritet në 4412(1000 ton).






Fig.1: Emisionet e CO<sub>2</sub> duke konsideruar drute e zjarrit si pjese e sektorit te pyjeve

Fig.2 : Emisionet e CO<sub>2</sub> duke konsideruar drute e zjarrit si pjese e sektorit energjetik [4611.33 Gg], 94 [4611.23 Gg], 1994

Sic shihet në figurë, kontribuesi kryesor i CO<sub>2</sub> është sektori energjitik (62.95%) për shkak të djegies së lëndës djegëse. Kontribuesi i dytë është Përdorimi i Tokës dhe i Pyjeve, i cili kontribuon me mbi 32.73%. Proceset industriale kontribuojnë me 4.30%, ndërkaq sektorë të tjere si: Mbetjet Urbane & Industriale, Solventet dhe Bujqësia, nuk kanë ndonjë kontribut. Emisionet e CO<sub>2</sub> nga drutë e zjarrit përfshihen në Përdorimet e Tokës dhe Pyjeve, për të lëksuar laklin që drute e zjarrit janë akoma një burim i rëndësishëm në Shqipëri dhe për më tepër, prerja e lëndës drusore nuk është hënë në rregull: në Shqipëri ka më tepër prroje sesa mbjellje. Në figure emisionet nga lenda drusore janë hënë nga sektori energjitik. Kështu që, në qoftë se emisionet nga lenda drusore raportohen nën sektorin energjitik, kontributi i këtij te fundit në GWP\*, (CO<sub>2</sub> ekuivalent) do të arrijë 65.39%. Konkluzioni i arritur në Dokumentin e Komunikimit të Parë Kombëtar të Ndryshimeve Klimatike është se sektori energjitik si në gjithë vendet e tjera është kontribuesi kryesor i gazeve me efekt sërë.

**Shënim;** GWP – Global Warming Potential = “Potenciali i Ngrahjes Globale”




Figura.3: Emetimet e GWP nga sektori energjetik sipas llogaritjeve paraprake bazuar ne Komunikimin e Dytë Kombëtar.

Që nga Tetori 2005, Njësia e Ndryshimeve Klimatike pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Mbrojtjes së Barimeve Ujore, ka filluar përgatitjet për Komunikimin e Dytë Kombëtar në kuadër të Konventës së Kombëve të



Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (Protokolli i Kiotos). Rezultatet e para të inventarit të emetimeve të gazeve me efektin serë tregojnë se emetimet nga sektori energjetik janë kryesoret (fig.3), dhe vëmenjda më e madhe duhet përqendruar në reduktimin e këtyre emetimeve. Për pasojë marrja e masave për reduktimin e tyre nëpërmjet nxitjes së shfrytëzimit të hurimeve të rinovueshme në përgjithësi dhe energjisë hidrike në veçanti ka një rëndësi themelore për mbrojtjen e mjedisit. Në këtë këndvështrim ndërtimi i HEC-it "Bregu i Madh" në përroit e fshatit Zalosnje du të japë një kontribut të rëndësishëm jo vetëm në reduktimin e gazeve me efekt serë (që shkaktojnë ngrohjen globale të atmosferës), por edhe në reduktimin e emetimeve që shkaktojnë ndotje lokale (shirat acide).

Gjatë dekadave të fundit veprimtari të ndryshme kanë ndikuar dukshëm në mjedisin rrethues në përgjithësi, dhe në atë ujor në veçanti.

Shkarkimet e ujrave të përdorura urbane dhe industriale në njrat sipërfaqësore janë tashmë një dukuri e rëndomtë, të cilat në mënyrë progresive kanë ndikuar në demtimin e cilësisë së ujrave në lumenjtë tanë. Këto ndikime, shpesh herë të njohura por edhe të panjohura, janë më të dukshme në impaktin që kanë në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin në përgjithësi.

Shfrytëzimi i baseneve ujëmbajtëse ka çuar në disa raste në prishjen e ekuilibrave natyrorë, për shkak të një shfrytëzimi pa kriter dhe pa rregulla sipas një ligëshmërie të caktuar shkencore. Shfrytëzimi baseneve ujore, është ndërrhyrje tepër e rëndësishme e aktivitetit normal të ujë.

Për këtë qëllim ndërhyrja, me synim shfrytëzimin e prurjes mesatare për prodhimin e energjisë, duhet koordinuar me aktivitetet tjera jetësore dhe ekonomike të zonës.

Vëmenje e veçantë duhet të ketë sidomos:

- kur këto basene janë afër qendrave të banuara,
- kur nga këto basene furnizohet pjesa e madhe e fshatrave përreth, për popullsinë dhe aktivitetet ekonomike të poshtëme të rrjedhes së përroit, duke filluar nga vendi i ndërtimit të HEC-it "Bregu i Madh".
- kur ka objekte industriale që janë të lidhur me nevojat për ujë teknologjik,
- kur zhvillohen aktivitete të akvakulturës,
- kur janë zona që kanë një status të veçantë, etj.

Prishja e këtyre ekuilibrave vjen si pasojë e një shfrytëzimi pa kriter të këtyre baseneve. Duhet të theksojmë se basenet ujëmbajtëse që nuk prishin këto kërkesa dhe që kanë rezerva të shumta të një cilësie shumë të lartë ka më shumicë në vëndin tonë.

Në nenin 4 (katër) të Ligjit Nr. 8990, datë 23.1.2003 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" (V.N.M.) është dhënë në mënyrë të qartë se cilat projekte i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis të cilat klasifikohen si më poshtë:

1. Procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis (V.N.M.) i nënshtrohen gjithë projektet e veprimtarite, që jepen në shtojcat 1 dhe 2 të këtij ligji, para miratimit të tyre nga organet përkatëse.
2. Projektet e veprimtarite i nënshtrohen dy niveleve të shqyrtimit për vlerësim e ndikimit:
  - a) Procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis nënshtrohen projektet e shtojcës 1 dhe projektet e veprimtarisë që kërkojnë të zbatohen në një zonë të mbrojtur.
  - b) Procesit të përcjellur të vlerësimit të ndikimit në mjedis (V.N.M.), të cilit i nënshtrohen projektet e shtojcës 2 dhe ndryshimet ose rikonstruksionet e projekteve të shtojcës 1.



Në respektim të përcaktimeve në Ligjin Nr. 8990, datë 23.1.2003 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" dhe Udhëzimin Nr.6, datë 27.12.2006 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis të një veprimtarie, kompania "HP ZAIOSH.NJA ENERGY" sh.p.k, është në fazën e hartimit të projektit të zbatimit të Hidrocentralit "Bregu i Madh"

**TAB.1. KLASIFIKIMI I RAPORTIT TE VLERESIMIT NE MJEDIS PER PROJEKTIN E NDERTIMIT TE HIDROCENTRALIT "BREGU I MADH"**

Pyetje që duhen marrë parasysh për klasifikimin gjatë projekti-zbatimit apo ushtrimit të veprimtarisë:	Përkrahje shkurtimisht: Po / Jo	Do të ketë ndërveprim / ndikim të rëndësishëm? Po / Jo - Porse?
1. Do të shkaktohen ndryshime fizike në territor (sh. topografike, përvëllime ose tërmet) në kushtet e projektit?	Po (gjatimet janë për ndërtimin veprave hidroelektrike)	Jo (ndërtimi i veprave do shfaqet me rimbledhjen e tokës dhe është kushtuar nga plani i ri i nevojave me tje të komunitetit dhe rrugës ekologjike Q <sub>100</sub> )
2. Do të perdoren burimet natyrore si: toka, uji, materialet ose energjit, veçmas në formë burime që mund të përdoren, shpesh ose me pak kohë?	Po (nëse shfrytëzimi vendoset sipas nevojave të burimeve energjike)	Jo (përparimtarisht në shpatet e përroit, toka e ujit që do përdoren, do marrë parasysh nevojat e komunitetit nga ajo dhe rrugës ekologjike Q <sub>100</sub> të përcaktuara në ligjin e përdorimit të tokës)
3. Përdoren përdozim, magazinimi, transporti apo prodhimi i substancave ose materialeve të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin?	Jo	
4. Do të prodhohen mbetje të ngurta?	Po (një pjesë e këmbës veprave hidroelektrike)	Jo (në gjithë mbedet e ngurta do të mbledhen dhe depozitohen në vendet e miratuar dhe mbeturit)
5. Do të ketë shpikime në ajër të ndotësve, substancave të rrezikshme, joksive ose helmuese?	Jo	
6. Do të ketë zhurmë e vibrime apo dritat e dritë, energjit ose rrezatim elektrik magnetik?	Po (zhurma-gjithë ndërtimit; rrezatim elektromagnetik nga linjat TM)	Po (do të ketë ndërveprim pas zotëzimit të veprave të përfunduar të mund të shfaqet gjatë tërheqjes së linjave të dritës)
7. Do të ketë rrezik për ndotjen e tokës e ujërave nga shkaktimi i ndotësve në sipërfaqen e tokës, ujërave sipërfaqësore, në tokë ose / në ujërat ose në det?	Jo	
8. Ka rrezik për shëndetin që ndikojnë në shëndetin e mjedisit apo në mjedis?	Po (gjatë ndërtimit të veprave hidroelektrike)	Jo (në të respektohen rregullat e sigurimit të kësaj pune)
9. Do të ketë ndikime sociale, demografike, mënyra të jetesës dhe jetesë, punësimi, etj?	Po (shpërthim i punës)	Po (që përparimtarisht do të përdoren)
10. Ka faktore të tjerë që duhen marrë në konsideratë si shëndet dhe që ndikojnë në punën mjedisore apo mund të përdoren ndikimi në ndryshime nga veprimtari ekzistues ose të planifikuar në zonë?	Jo	
11. Ka zona të mbrojtura nga ligjet dhe / ose ndërkombëtare / kombëtare për vlerat e jetës natyrore, vlerat ekologjike, jashtëzakonshme, vlera kulturore, historike e arkeologjike?	Po (Zona e Mbrojtur me V.K.M. nr.432 datë 18.07.2007)	Jo (Në këtë zonë nuk ka dëmtim të Zona mbrojtur në kufijtë e ligjit të zonës së mbrojtur në mbrojtjen e vlerave dhe lirisht. Të gjitha veprimtariat që shfaqen përveç kryerjes së punës duke respektuar kushtet e punës dhe për punëfundit të ndërtimit do të rimbledhen mjedisit dhe paisazhit)
12. Ka zona të ndëshme mjedisore, si zona brejtore, ujit, pyje, eallat, lloje, bimë e ajër, shkëlqim në zonë?	Po (në tokë, tokë të pjesshme)	Jo (ndërtimi i hidrocentralit qëllon që të rimbledhet, pasi këto janë të rrezikuara dhe të



13. Ka zona me spore të mbrojtura, të rëndësishme ose të ndajshme, të rrezikuara, kërcënuara, në rrezik shkolleje të lirisë e lirisë, p.sh. për kryeqendrat, shkolletime pushime, dëgjimore, muzikë etj. në zonë?	Jo	Jo
14. Ka zona me ujëra subterranë, në rrezik ose të përdetare në zonë?	Po (qym tëkësore)	Jo (vërejtje ndërkohë në shpatet e përtaq, Sasia e ujit që do përdoret do marrë parasysh nevojën e momentit për ujë dhe trijellat të detyrueshëm të përcaktuara në ligjin e përdorimit të ujit)
15. Ka zona me tipare të spikitura përmesime ose shpatë në zonë?	Jo	
16. Ka rrugë e trafikimit të ngjashme që përdoren nga publiku për të shkuar në vende pushimi etj. ose rrugë transporti të mbingrënjara që mund të ndikohen?	Po (rrugë spikitura / trafikim tërësisht me Çështje)	Jo (vërejtje tëkësore në lidhje me rrugën e cilësimit të kësaj lloji)
17. Ka përdorime të rrezikuara të tokës (të tregut, industri, tregti, pushim, shpirtësi, pyje, turizëm, zona të gjelbra, sportive, argëtime, prapa të tjera private etj.) ose plan të ndalshme që ndalojnë?	Po (tregti dhe qasërisht private)	Jo (nuk ka ndikim të rrezikshëm për të të rrezikshëm të tokës)
18. Fshin zona në rrezik të rrezikimit ose demitimit mjedisor i kushtetshëm mjedisor i njëkohshëm?	Jo	
19. Është zona me probleme të përkohshme, të shpatës dhe të detyrueshëm mjedisor, përmbajtje, kërkime dhe shpatë (për shpatë të temperaturës, mjegulla etj. të lirisë)?	Jo	

## 2. KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

### 2.1 Politika

Qeveria Shqiptare në Maj të 2015 aprovoi Strategjinë Kombëtare të Energjisë, si një dokument bazë të zhvillimit të të gjithë sektorëve energjëtike deri në vitin 2030. Strategjia analizon tre çështje:

- 1) Situata e furnizimit dhe kërkesës së energjisë deri në vitin 2030.
- 2) Strukturën institucionale të sektorit të energjisë.
- 3) Përgatitjen e paketeve financiare dhe të afateve kohore për implementimin e secilës masë, në bazë të rekomandimeve të rezultuar nga Strategjia Kombëtare e Energjisë.

Objektivi Primar i Strategjisë Kombëtare të Energjisë është:

**“Rikonstruimi i sektorit energjëtik bazuar në parimet e ekonomisë së tregut si dhe në zhvillimin e një politike bashkëkohore energjëtike”**

Strategjia Kombëtare e Energjisë parashtron kërkesat e domosdoshme për të plotësuar detyrimet e vendit tonë përkundrejt Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike në vendet e Europës Jug-Lindore. Për këtë vendi ynë duhet të plotësojë të gjitha obligimet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe të harmonizojë zhvillimin e sektorit energjëtik në përputhje me Direktivat e Bashkëpunimit Europian, për të bërë të mundur asociimin e Shqipërisë në Europën e Bashkuar.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit Qeveria ka filluar zhvillimin e një kuadri ligjor për të ndryshuar degradimin mjedisor, i cili ka ardhur si rezultat i industrializimeve të mëparshme dhe ka anashkaluar mbrojtjen e mjedisit përmes plotësisht. Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit, i cili kërkoi “të mirëmbajtje të mjedisit të përshatshëm, të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”. Legjislacioni kërkoi gjithashtu që treguesit urban duhet të shfrytëzohen racionalisht në përputhje me principe të bazuara

### 2.1.1 Masterplani i Gjenerimit të Energjisë Elektrike

Për periudhën afatgjatë (deri në vitin 2030), dhe duke pasur parasysh edhe kohën e ndërtimit të centraleve të reja, nevojat shtesë gjeneruese të Shqipërisë do të plotësohen vetëm duke rritur importin (i cili do të përdoret si ngarkesë bazë) (deri në 2.5 - 3.0 TWh/vit). Për pasojë, është e rekomandueshme të mbahet në planifikim niveli i importit të vitit 2001 (1.7 TWh/vit) dhe të përdoret për instalimin e TEC-rit CCGT (135 MW), i cili të arrijë të vihet në punë në vitin 2009 (fig.4).




Figura.4: Masterplani i Zhvillimit të Gjenerimit të Energjisë Elektrike

Gjithashtu mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Energjisë Illogarite, që të instalohen burime gjeneruese me rreth 2000 MW, nëpërmjet Hec-ve të vogël me një prodhim mesatar rreth 9000 GWh/vit. Për të përballuar nevojat shtesë elektro-energjetike dhe për të reduktuar nivelin shumë të lartë të importit, në skenarin aktual të Strategjisë Kombëtare të Energjisë janë konsideruar për tu identifikuar si TEC-o ashtu edhe Hec-o, ato kandidatë të cilët do të mbështesin mbulimin e nevojave të reja shtesë.

Përfirimi më i madh nga shfrytëzimi i energjisë ujore realizohet nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të medha, por interes paraqet edhe shfrytëzimi i energjisë ujore nëpërmjet hidrocentraleve të vogël. Këto hidrocentrale janë kryesisht të tipit me derivacion dhe shfrytëzojnë burimet dhe rrjedhat ujore pranë këtyre zonave dhe moshë mesatare e këtyre hidrocentraleve është 50 vjeçare.

### 2.1.2 Masterplani i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike

HEC-ot e vogël shumica e tyre janë të lidhur me rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike. Për pasojë efektiviteti i tyre varet gjërësisht jo vetëm nga pozicioni i tyre (lartësia e ujit, prurjet e ujit, investimet për realizimin e skemës) por edhe nga gjëndja e sistemit shpërndarës, i cili do të bëjë të mundur transportin e kësaj energjie në nënstacionin më të afërt. Prandaj në vijim është dhënë shkurtimisht Masterplani i Zhvillimit të Sistemit të Shpërndarjes duke përfshirë edhe rajonin jug-lindor të vendit, sistem në të cilin do të lidhet Hec-i "Drega i Madh".

Qëllimi i projekteve të investimeve në sektorin e shpërndarjes, do të përfshijë abandonimin gradual të sistemit 35/10/6 kV, duke e zëvendësuar atë me sistemin 110/20kV, që përdoret gjërësisht në Europë, me synimin që në fund të fazës së rehabilitimit të gjithë transformatorët të jenë zëvendësuar me transformatorë 110/20 kV. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit Qeveria ka filluar zhvillimin e një kuadri ligjor për të ndryshuar degradimin mjedisor,





i cili ka arritur si rezultat i industrializimeve të mëparshme, dhe ka unashkalluar mbrojtjen e mjedisit përmes plotësisht. Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit, i cili kërkon **“të mirëmbaje ujë mjedis të përshtatshëm, të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”**. Legjislacioni kërkon gjithashtu që rregullat urban duhet të shfrytëzohen racionalisht në përputhje me principe të bazuara.

## 2.2 Baza Ligjore


Ndërgjegjësimi në Shqipëri është i një niveli të ulët, kjo si rrjedhojë e një legjislacioni mjedisor relativisht të ri që është në zhvillim dhe po plotësohet me tej sidomos më rregullorë dhe standarde.

Aplikimet për V.M.M. kanë si detyrim paketën ligjore të mëposhtme:

- Ligji Nr. 8934, dt. 05.09.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 8990, dt. 23.01.2003 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.249, dt. 24.04.2003 “Për Miratimin e Dokumentacionit për Leje Mjedisore dhe të Elementeve të Lejes Mjedisore”.
- Udhëzues metodik i Ministrisë së Mjedisit, Tiranë, “Për Përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 805, date 04.12.2003 “Për Miratimin e Listes së Veprimtarive që Ndikojnë në Mjedis për të cilat kërkohej Leje Mjedisore”.
- Urdharrin e Ministrisë Nr. 137, date 17.08.2004. “Për Dokumentacionin e Domosdoshëm për të kërkuar Leje Mjedisore”, etj
- Udhëzimin Nr.6, date 27.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis të një veprimtarie”
- Ligj Nr.10431, Datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen E Mjedisit”
- Ligj Nr.10440, Datë 7.7. 2011 për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis
- Ligji Nr. 111/2012, date 03.12.2012 “Për Menaxhimin E Integruar Të Burimeve Ujore”.
- Ligj Nr. 60/2014 Për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, Datë 14.7.2011, “Për Lejet E Mjedisit”, të ndryshuar

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbatuese të ndikimit të projektit në mjedisin fizik dhe social. Ky proces zhvillohet brenda atij të planifikimit dhe zbatimit të projektit, duke paraqitur prioritetet mjedisore dhe listen e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Raporti realizon bashkëpunimin midis pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe biznesit, duke i paraprirë zhvillimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm.

Në vijim janë përshkruar vecoritë kryesore të projektit, të cilat, së bashku me investimet në vendin e ndërtimit të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit, kanë shërbyer për identifikimin e ndikimeve të ndërtimit të hidrocentralit “Bregu i Madh” në mjedis, objekti i këtij vlerësimi.



### 3. PERSHIKRIMI I PROJEKTI

#### 3.1 Pozicioni gjeografik

Zona në të cilën përshihet pellgu ujëmbledhës i përroi të Zaloshnjës, nga pikëpamja gjeografike ndodhet në Kratinën Malore Jugore (Lugina e Tomorricës).

Pellgu ujëmbledhës i përroit të Zaloshnjës ndodhet në pellgun ujëmbledhës të Tomorricës, një ndër degët kryesore të lumit Devoll. Përroi i Zaloshnjës ndodhet në pjesën e sipërme të luginës së Tomorricës në krahun e majtë të saj.

Nga veria përroi i Zaloshnjës kufizohet me malin Bregu i Madh (1161 m mbi nivelin e detit mrd), nga lindja me lumit e Tomorricës ku e ka dhe derdhen e tij, nga jugu kufizohet me përronj të vegjël që derdhen në lumit e Tomorricës dhe me zona malore rreth 1000 m m.n.d., ndërsa nga perëndimi kufizohet me masivin malor të m.Zaloshnjës me kuota të larta që arrijnë deri në 2100 m m.n.d..

Nga ana morfometrike lugina e Tomorricës ndahet në dy pjesë; pjesa e parë është nga burimi deri në qendren e bazarit Gjerbes ku het pjesë dhe zona në studim, në hregun e majte të lumit të Tomorricës (në lshatin Zaloshnjë. Bregu i majtë i lumit të Tomorricës në zonën në studim) është i ngushtë dhe shumë i pjerrët.

Pellgu ujëmbledhës i përroit të Zaloshnjës në pjesën e sipërme të tij përbëhet prej formacionesh gëlqerore shtrësore të çarë dhe të karstëzuar (me ljalë të tjera shtrës me pëchajpe të gjerë dhe me ujëmbajtje të madhe). Në pjesën e poshtme deri në veprën e marrjes përbëhet prej formacionesh flishi (argjila alevrolite ranore- pra shkëmbinj shumë të vartër në ujera nëntokësore. Ajo ka ndërpriten shtrësat karbonatike me ato flishore dalin burime ujërash nëntokësore.

Malesa bimore përfaqësohet kryesisht prej shkurreve mescheture të tipit të makjeve, sidomos në hregun e majtë të lumit të Tomorricës ku ndodhet zona në studim. Mbi këtë zonë është brezi i dushkut dhe në lartësitë e mëdha mbi 1000 m janë pyjet e alut.

Në pellgun ujëmbledhës të përroit të Zaloshnjës mbizotërojnë tokat e hirta kafë dhe të kafenjla nga 600 deri në 1000 m m.n.d.. Ato janë formuar mbi shkëmbinj të nëryshëm me relievet të larmishëm. Tokat e murrme pyjore shtrihen në lartësitë 1000 deri në 1700 m m.n.d., dhe janë në klimë të ftohtë dhe nën pyjet e alut dhe haloreve. Nga ana administrative zona në studim hyu në Qarkun e Beratit, Rrethi i Skraparit.

#### 3.2 Statusi i zones së studimit dhe objektivi i projektit

Projekti i Hidrocentralit "Bregu i Madh", parashikon të shfrytëzojë përroit e rëshatit Zaloshnjë dhe mjedhën e ujrave që burtojnë në këtë pellg ujëmbledhës e cila është në përputhje dhe e bazuar në Strategjinë Kombëtare të Energjisë.

Zona në ljalë është nën administrimin e Qarkut Berat. Një përshkrim i mirëfillte i saj do të na ndihmojë për të kuptuar rëndësinë e ndërtimit të këtij hidrocentrali. Vepra e Marrjes Nr.1 do të ndërtohet në një gjuhë të ngushtë në kuotën 953.0 m m.n.d. në një peraske malore mbi depozitimet flishore të Oligocenit të mesëm, të përfaqësuar nga alevrite, ranore dhe argjilite. Kjo shtrësë paraqet një përjirim që shkon deri në thellësinë 3.0 deri në 5.0m. Mbi



këto depozitime kemi një mbulësë deluviale-proluviale me një trashësi të kufizuar që luhetet në intervalet 1.0 deri në 2.0ml. Kjo vepër nuk paraqet probleme gjeologjiko-inxhinerike.

Vepra e marjes Nr.2 do të ndërtohet në një grykë të ngushtë në kuotën 880.0 m.m.n.d. në një përoskë malore mbi depozitimet flishore të Oligocenit të mesëm, të përfaqësuar nga alevrite, ranore dhe argjilite. Kjo shtresë paraqet një përjirim që shkon deri në thellësinë 3.0 deri në 5.0m. Mbi këto depozitime kemi një mbulësë deluviale-proluviale me një trashësi të kufizuar që luhetet në intervalet 1.0 deri në 2.0ml. Kjo vepër nuk paraqet probleme gjeologjiko-inxhinerike.

Shoqëria "IIP ZALOSHINJA ENERGY" Sh.p.k. me qendër në Tiranë ka marrë me konsension të formës B.O.I. Ndërtimin, Operimin dhe Shfrytëzimin e Hidrocentralit "Bregu i Madh", në pellgun ujëmbledhës të përroit të fshatit Zaloshnjë në zbatim të ligjit Ligji Nr. 9663 dt.18.12.2006 "Për Koncesionet" dhe V.K.M. Nr. 27 dt. 19.01.2007 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve". Zhvillimi i këtij aktiviteti bazohet në studimet konkrete, të reja dhe të hershme hidrologjike, gjeologjike, elektrike, topografike etj.

Shoqëria " HP ZALOSHINJA ENERGY" Sh.p.k ka angazhuar për llogari të saj studion e projektimit "MEGAWAT" sh.p.k që ka në grupin e saj specialiste hidrologje, gjeologje, hidroteknike, elektrik dhe topograf, të cilët pas disa rikonicioneve përkatëse në terren në një pjesë të përroit, ujoljes me relievin topografik, me tipin e rrjedhjes ujore me prurjen e përgjithshme të tyre, si dhe me kushtet gjeologjiko-inxhinerike, kanë realizuar konceptimin e skemes së shfrytëzimit hidroenergjetik të pellgut ujëmbledhës të përroit të Zaloshnjës në zonën e fshatit Zaloshnje në Bashkinë Skrapar.

### 3.3 Karakteristikat klimatike

Në bazë të ndarjes klimatike të vençit tonë, zona që po studiojmë ndahet në dy nënzona klimatike. Pjesa e sipërme e pellgut ujëmbledhës të përroit të Zaloshnjës bën pjesë në Nënzonën Klimatike Mesdhetare Malore Juglindore të Shqipërisë. Dimrat janë të ftohtë me temperatura të ulta ku ditët me temperaturë negative janë të konsiderueshme. Pjesa e poshtme e pellgut të përroit të Zaloshnjës llyh në Nënzonën Klimatike mesdhetare kodrinore qendrore. Kjo nënzona karakterizohet me një regjim më të ngrohtë.

Temperatura e ajrit është një ndër elementët kryesore në përcaktimin e veçorive klimatike të një zonë të caktuar me anë të regjimit të temperaturës mesatare, me sezonin e saj brendavjetore si edhe me vlerat ekstreme. Në zonën në studim, si vendmatja më e afërt meteorologjike është marrë ajo e Ujanikut.

### 3.4 Të dhëna mbi prurjet e përroit të Zaloshnjës

Për studimin e rrjedhjes ujore të përroit të Zaloshnjës jemi bazuar në të dhënat e zonës përroit m,q se në pellgun ujëmbledhës të tij nuk ka asnjë të dhënë hidrometrike. Siç është thënë më sipër, pellgu ujëmbledhës kufitar i përroit të Zaloshnjës është përroi i Bogovës që ka të dhëna hidrometrike. Nga pëpunimi i informacionit të përroit të Bogovës rezultoi se prurja mesatare shumëvjeçare është 1.94 m<sup>3</sup>/s ndërkohë që sipërfaqja ujëmbledhëse është 57 km<sup>2</sup>. Prej kësaj rezulton se moduli (prurja specifike) i prurjes vjetore për përroit e Bogovës të jetë 34 l/s/km<sup>2</sup>.



Gjithashtu pak me në jugë të përroit të Zalosnjës ndodhet lumi i Çorovodës, i cili ka një seri 40 vjeçare të dhënash dhe për të cilin modeli victor rezultoi rreth  $36 \text{ l/s/km}^2$ .

Duke u bazuar në informacionin e mësipërm si edhe faktin që sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës që është marrë në studim është mjaft e vogël dhe që në kreshtat perëndimore kemi kura rreth 2000 m por edhe me topër, hidrologji është i mendimit të pranojmë një modul prej  $40 \text{ l/s/km}^2$  për pellgun ujëmbledhës të përroit të Zalosnjës. Nga kjo rezultoi se prurja mesatare për të dy veprat e marra së bashku është  $0.150 \text{ m}^3/\text{s}$ , e cila ndahet sipas veprave të marrjes respektivisht në  $0.050$  dhe  $0.100 \text{ m}^3/\text{s}$ .

Për të llogaritur parametrat e tjerë hidrologjike të veprave të marrjes të përroit të Zalosnjës analogjinë e kemi vazhduar me lumit e Çorovodës duke përdorur raportet e prurjeve mesatare vjetore respektive.

### 3.5 Shpërndarja brendavjetore e rrjedhjes ujore

Në bazë të llogaritjeve përkatëse në tabelë janë dhënë prurjet mesatare mujore për secilën veprë marrje, ndërsa në figurën është dhënë paraqitja grafike e tyre:

Tab. 4 Prurjet mesatare mujore, veprat e marrjes Përroi i Zalosnjës

Aktet	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Vm 1	0.076	0.072	0.071	0.081	0.068	0.034	0.017	0.011	0.013	0.023	0.065	0.071	0.050
Vm 2	0.148	0.142	0.142	0.162	0.135	0.068	0.035	0.022	0.026	0.046	0.150	0.143	0.100




Fig. 3 Shpërndarja brendavjetore e prurjeve, Vm prr Zalosnjës





### 3.6 Relievi dhe gjeomorfologjia

Rajoni që po merret në studim ndodhet midis dy zonave tektonike, atyre të zonave strukturalo-faciale të Krujës, nënzona e Tomorit, dhe zonave strukturalo-faciale të Krast-Cukalit, nënzona e Krastes. Zona jone në studim shtrihet kryesisht mbi depozitimet flishore të Palooçenit. Depozitimet që takojmë në afërsi të zonës tone në studim janë:

#### ZONA

Zona e Krujës përfaqëson një kufizore që kufizohet në lindje me zonën tektonike të Krasto-Cukalit ndërsa në perëndim me zonën Jonike dhe zonën e Adriatikut Jugor. Gjate gjithë kufirit tektonik lindor, vërehet branisje e flisheve dhe rralle here edhe gëlqeroreve globotrunkanike të nënzonaes së Krastes mbi fliшин oligocenik të zonës Kruja. Kontakti me zonën e Adriatikut Jugor dhe zonën Jonike nuk është kado i qartë dhe i prerë. Ky kuç është i diskutueshem sidomos për pjesën jugore (nga antiklinali i Tomorit e më në jug). Zona tektonike e Krujës, në të gjitha studimet e realizuara deri tani, është trajtuar si një zonë e vetme nga Leskoviku në jug, deri në Shkodër në veri. Disa studiues (Misha, etj. 1982, etj.) mbështetur në praninë e foraminifereve planktonike në depozitimet pelagjike të Kretakut në antiklinalin e Melesinit, e kanë trajtuar këtë të fundit si njësi të zonës Jonike. Studimi tematik për deshifrimitin biostratigrafik të depozitimeve karbonatike të zonës Kruja (Koroveshi, etj. 1999) solli të dhëna të rëndësishme biostratigrafike të cilat tregojnë për ndryshime të theksura të facies karbonatike nga veriu në jug. Në pjesën veriore, në të gjitha prerjet stratigrafike të kryera në depozitimet karbonatike rezultojnë vetëm foraminifere bentosike, që janë tipike për facien neritike. Këtu hec përjashtim struktural me perëndimore, ajo e Ishmit, ku nga analizat e kryera në kampionet e marra në pusin Ish.1, ka rezultuar faune e perziere, e cila interpretohet si kalimtare për në zonën Jonike (Nakuçi etj. 2001). Në jug, në antiklinalin e Tomorit, në depozitimet e Kretakut të sipërm janë takuar foraminifere planktonike krahas atyre bentosike, po kështu dhe në Kulmave e Qeslibesh, (shih kap. e stratigrafisë) dhe sidomos në Melesin ku takohen vetëm foraminifer planktonike. Duke analizuar kohën e ndryshimit, facien e depozitimeve karbonatike dhe stilin tektonik vëlet të qartë një ndryshim i dukshëm ndërmjet strukturave në rajonet nga Elbasani e më në veri nga ato më në jug. Në veri të Elbasanit strukturat janë lineare, kryesisht izoklinale, me facie neritike, të karakterizuara nga praninë e foraminifereve bentosike, me moshe të orogjenezës në fund të Oligocenit të hershem. Ndërsa strukturat në pjesën jugore janë të natyrës antiklinale ose brantantiklinale me facie të perziere, me fenomene paleogeografike dhe me moshe më të vonshme të orogjenezës (në fund të Oligocenit të mësem). Ky dallim esencial interpretohet si efekt i ndikimit të tërthores Vlorë – Elbasan – Diber, në jug të së ciles ndërtimi tektonik kondicionohet dhe nga praninë e prishjeve të çera tërthore dytesore dhe tektonikas kripore. Nisur nga veçoritë e mesipërme, për të evidentuar më mirë ndërtimin tektonik të kesaj zone, përshkrimin tektonik të saj do ta bëjmë sipas dy nënzonaes tektonike të kondicionuar nga thyerja e thellë tektonike e lindur qysh në kohën e riftezimit të Albanideve të Jashteme.

#### NENZONA E TOMORIT

Nënzona e Tomorit përshhin rajonet në jug të tektonikas tërthore Vlorë-Elbasan-Diber. Tipar dallues është praninë e strukturave me morfologji me të zhvilluar në buzën perëndimore të saj. Strukturat janë të tipit antiklinal me periklinale e qala ndarese të dallueshme, si dhe të tipit horst-graben. Facia e depozitimeve karbonatike është kalimtare, ku gjejmë zhvillim si foraminiferet bentosike dhe ato planktonike, me përjashtim të antiklinalit të



Tervollit: Orogeneza e këtyre strukturave pranchet në fund të Oligocenit të mesëm. Nga perëndimi në lindje dallohen këto vargje antiklinalë:

3.3	Do ndikojnë projekti, në rritjen e aftësive?	Po	Interaksi pozitiv	Po (hapen vende pune dhe punonjësit të njëjtit të furnizimit me energji)
3.4	A ka grup gjatësia që mund të ndikohen nga projektet, si të semund apo të moshaan?	Jo		
3.5	S'është të tjerë?	Jo		
<b>4. A do të prodhohen mbeturina të ngurta, gjate ndërtimit, shfrytëzimit ose ndërtimit jashtë funksionit?</b>				
4.1	Mbeturina dhe shkollat ose minierash?	Po	Nga gurat për ndërtim e veprave të tjerë.	Jo (do të rehabilitohet sipa ligjit të tjetër për punë pa grumbullim me ndërtim)
4.2	Mbeturina urbane (shërbime të tjerë)?	Jo		
4.3	Mbeturina të rrezikshme të tokës apo të ujërave?	Jo		
4.4	Mbeturina të rrezikshme të proceseve industriale?	Jo		
4.5	Produkte shpirtërore?	Jo		
4.6	Ujra të zinj ose llaç të rrezikshme të shpirtërore të llaçit?	Jo		
4.7	Mbeturina ndërtimit ose shërbime?	Po	Nga ndërtimi i veprave të tjerë, me kushte të tjerë.	Jo (do të restorohet tek në nivelin e nivelit, do të depozitohen në vend grumbullimit të mbeturinave të ngurta të përcaktimit me parë)
4.8	Mbeturina pakumësh ose paqëndrueshme?	Jo		
<b>Pyetje që duhet të mbahen parasysh gjate parazgjedhjes</b>				
4.9	Tëka të ndërtimit ose shërbime të tjerë?	Jo		
4.10	Mbeturina të tjerë?	Jo		
4.11	Mbeturina të tjerë të ngurta?	Po	Grate ndërtimit	Jo (do të heqjen dhe vendosin në vend grumbullimit të mbeturinave të ngurta)
<b>5. A do të shkaktohen ndryshime në ajër ose ndryshime të tjera të rrezikshme të tokës apo të demshme për shëndetin nga projektet?</b>				
5.1	Shkaktojnë nga erëzimi të ndryshmeve nga llojet e ndryshme të levizshme?	Po	Ndërtimi nga erëzimi i kuzinovë, shkarkuesve, shpirtërore dhe ndërtimit.	Po (do të përdoren këto makineri me optimizimin e tyre do të jenë pjesë të llojeve të tjerë të tjerë të tjerë)
5.2	Shkaktojnë nga erëzimi të prodhuesve?	Jo		
5.3	Shkaktojnë nga erëzimi i mbeturinave, për të cilat ndërtimi ose transportin?	Jo		
5.4	Shkaktojnë nga erëzimi i ndërtimit për të cilin janë përdorur?	Jo		
5.5	Mbeturina të tjerë të ndërtimit nga punë dhe material të ndërtimit, gjatë ndërtimit?	Jo		
5.6	Shkaktojnë nga erëzimi i ndërtimit?	Jo		
5.7	Shkaktojnë nga erëzimi i ndërtimit?	Jo		
5.8	Shkaktojnë nga erëzimi i ndërtimit?	Jo		
<b>6. A do të shkaktojnë projektet zhurmë dhe vibracione ose rrezik të dërrës, energji të rrezatimit ose rrezatim elektromagnetik?</b>				
6.1	Nga punë e punëve të tjerë, frango, ventilator?	Po	Nga ndërtimi i veprave	Jo (punojnë sipas ligjit të tjetër për punë pa grumbullim me ndërtim)
6.2	Nga proceset industriale apo të ngajshme?	Jo		
6.3	Nga ndërtimi apo punë?	Po	Nga ndërtimi i veprave	Jo (punojnë sipas ligjit të tjetër për punë pa grumbullim me ndërtim)
6.4	Nga plazje apo llaç të pilotash?	Jo		





6.5	Nga trafiku gjate ndertimit, a-e shfrytezimit?	Po	Nga ndertimi i vprave	Jo (puni me kryhen larg rreth 500 banor dhe gjate orëve te ditës)
6.6	Nga proceset e ndertimit ose shfrytes?	Jo		
6.7	Nga burimet e rrezikut mit efektit negativit i efektet mbi pajisjet dhe zjarrçudit)	Po	Nga ndertimi i vprave	Jo (puni me kryhen larg rreth 500 banor dhe gjate orëve te ditës)
6.8	Nga qe burime jete?	Jo		
7. A do te coje projekti ne rreziqe te ndotjes se tokes, ujrit nga shkak kimet e ndotesave ne toke ne kanalizimet e njrave te bardha dhe te zeza, ujrave sipërfaqesore, nentokesor, bregdetare ose ne det?				
7.1	Nga perpunimi, deposizimi, perdorimi i oca shkaterrim i vendave te rrezikshme e tokave?	Jo		
7.2	Nga shkak kimet e njrave te zeza ose qelbjeve te tjera (thyrimet e parafundit) ne uje ose toket?	Jo		
7.3	Depozitimi ndotesave te shkakuar ne gjate uje te zeza	Jo		
7.4	Nga oca ndotjet?	Jo		
7.5	A ka rrezik te shkakuar akumulimi i fangjate te ndotesave ne mjetet nga kate burime?	Jo		
8. Ekziston rreziku i aksidenteve gjate ndertimit apo shfrytesimit te projektit qe mund te ndilloje ne shendetin e njerezve apo mjedisit?				
8.1	Nepertshime, ngara, nxjerje nga deposizimi, perdorimi i produkteve i substancave te rrezikshme e tokave?	Jo		
8.2	Nga ngjarje qe kapercenje shifite e mbrojtje normale te mjedisit, p.sh. demime i sistemeve te kontrollore mjedisit?	Jo		
8.3	Nga ndertje shkak tjeter?	Jo		
8.4	Mund te ndikohet projekt nga fakte qe ne njere qe shkaktojne demime per mjedisin (pambyllje, termetet shkaktojne)?	Jo		
9. A rezultoi projekti me ndryshime sociale, ne demografi, menyre tradicionale jetese, punesim?				
9.1	Ndeshim me mundicat ne e paparlshite, moarte, strukturen, grupe sociale etj?	Jo		
9.2	Nga strehimi i njerezve apo prishja e shtrave, mjedisve te komunitetit, si shkak i, qe shkaktohet mjedisit?	Jo		
9.3	Nepertshime mjedisit i shkaktohet ne njere qe shkaktojne te kerkantet e reja?	Jo		
9.4	Nga rreziket i shkaktohet ne njere per mjedisin shprehim sociale, strukturen, demime, shendet?	Jo		
9.5	Nga krijimi i vendave te punesimit me njere qe shkaktojne te kerkantet e reja te vendave te punesimit me pasqira ne pajunesi e ekonomit?	Po	Nga ndertimi i shprehim sociale	Po (shpallje pozitive nga bregje e vendave te punesimit)
9.6	Ndeshim shkak tjeter?	Jo		
10. A do te coje projekti ne presion per zhvillime te mjedisit qe mund te kene ndikim te rrezikshem ne mjedis, me shume banor, rruge te reja, industri, veprimtari mbeshetese				
10.1	A do te coje projekti ne presion per zhvillime te mjedisit qe do te kene ndikim te rrezikshem ne mjedis, si me shume strehim, rruge te reja, industri, shprehim publike mbeshetese te reja?	Po	Nga ndertimi i shprehim sociale	Fritje e aktivitetit te shprehim sociale me shume per projektin e kerkantet
10.2	A do te coje projekti ne zhvillime te mjedisit e mbeshetese zhvillime mjedisit ose zhvillime te njera nga projekt qe te kene ndikim mjedisit, si: 1. Infrastruktura mbeshetese (rruge, furnizim me energji elektrike, ngritim te mbetjeve ose urrave te perdorura etj.) 2. Zhvillim i strehimit; 3. Industri nxjerese (elektrike, etj.) 4. Industri furnizuese, 5. Te tjera	Jo Jo Jo Jo Jo		
10.3	A do te coje projekti ne riperdorem te lantit mit pas shfrytesimit te tij	Jo		



	që du të kërkojnë më në mëdhis?		
10.4	A ka të njëjtin projekt të krijimit të tre pravekëve për dhe lumenjtë me oshurim?	Jo	
10.5	Do të ketë projektat pasqer kurrë të vësir nga të tjerat me projektet e tjera ekzistuese ose të planifikuara e me pasqer të ngjashme?	Jo	

## 7. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE DHE VLERESIMI I SITUATES

### 7.1 Ndikimet e mundshme në mjedis gjatë fazës së operimit të HEC: Krahësimi i Reduktimit të Gazeve me Efekte Serë dhe Gazeve që Shkaktojnë Shium Acid

Metodika e njohur e Panelit Ndërkombëtar të Ndryshimeve Klimatike rekomandon që reduktimet e emetimeve të GHG (Gazeve me Elekt Serë) që rezultojnë nga ndërtimi i HEC-ëve të vegjël. Efekti i Ngratjes Globale (GWP) shprehët nepermjet emetimeve të CO<sub>2</sub>, N<sub>2</sub>O, CIL<sub>4</sub> të shprehura në CO<sub>2</sub>-ekuivalent. Përvaktimi i efektit të CO<sub>2</sub> tek GWP është i barabartë me 1. Ndërsa për gazet të tjera shprehët nepermjet vlerave të dhëna në tabelle për një periudhë 100 vjeçare të marrë në analizë.

Gazet me efekt serë	Periudha 20 vjeçare	Periudha 100 vjeçare
Diekzidi i Karbonit (CO <sub>2</sub> )	1	1
Metani (CH <sub>4</sub> )	25	31
Oksidi i Azorit (N <sub>2</sub> O)	120	120

Le të analizojmë emetimet që do të eliminohen nga një impiant ekuivalente me HEC-in që do të ndërtohet, meqënëse në se nuk do të ndërtohet Hec-i për të garantuar furnizimin e energjisë do të përdornim teknika të tjera furnizimi me energji elektrike të kësaj zone. Bazuar në programin GACMO, përgatitur nga Instituti Danëz i Mjedisit, janë llogaritur gazet me efekt serë (CO<sub>2</sub>, CIL<sub>4</sub>, N<sub>2</sub>O) tre teknika me të mundëshme për furnizimin me energji elektrike janë:

1. Sigurimi i të njëjtës fuqi dhe energji elektrike sa dhe Hec-i nepermjet një motori me djegie të brëndëshme dhe me lëndë djegëse diezel ose benzinë (i ngjashëm me gjeneratorët që përdoren në qytete dhe sektor industrial për të siguruar energjinë kur nuk kemi furnizim nga rrjeti).
2. Sigurimi i të njëjtës fuqi dhe energji elektrike sa dhe Hec-i nepermjet një TEC-i me cikël të kombinuar (si teknologjia e TEC-it të ri) dhe me lëndë djegëse diezel marine.
3. Sigurimi i të njëjtës fuqi dhe energji elektrike sa dhe Hec-i nepermjet një TEC-i me avull (si TEC-i i Tjerit) dhe me lëndë djegëse mazul.

Sipas analizës së bërë rezultoi se si pasojë e ndërtimit të Hec-it Bregu i Madh, imbi përmirësimit të Zaloshtjes do të bëhet i mundur reduktimi i gazeve me efekt serë në një vlerë totale për të gjithë periudhën 35 vjeçare të jetëgjatësisë së HEC-it me 155295 ton, 85588 ton, 122269 ton në se do të zëvendësojë një central elektrik me motor



diezel, një TEC me cikël avullë dhe një TEC me cikël të kombinuar. Ky është një konkluzion shumë i rëndësishëm pasi mund të përdoret për shitjen e këtyre enelimeve, vendeve të caktuara që kanë obligim për plotësimin e targetave të Protokollit të Kiotos. Blerja, duke përdorur mekanizmin CDM të Protokollit të Kiotos do të bëjë të mundur sigurimin e granteve të caktuara për të përballuar një pjesë të investimit fillestar.

Ky është një konkluzion shumë i rëndësishëm, pasi mund të përdoret për shitjen e këtyre enelimeve, vendeve të caktuara që kanë obligim për plotësimin e targetave (çfaqeve) të Protokollit të Kiotos. Blerja duke përdorur instrumentin CDM (Clean Development Mechanism Mekanizmi i Teknologjive të Pastra) të Protokollit të Kiotos do të bëjë të mundur sigurimin e granteve të caktuara për të përballuar një pjesë të investimit fillestar dhe për të marrë shumë me tepër leveredizhuërinë financiare dhe mjedisore të Hee-it.

## 7.2 Rrymat Endogjene dhe Risku i Tyre

Efektet potenciale mbi shëndetin e njeriut të fushave elektromagnetike kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve që nga vitet 1980 deri në ditët e sotme. Në vitin 1987 një studim i njohur amerikan, realizoi studimin për montatorët që punojnë në linjat e TM (110, 220 dhe 400 kV) dhe vërejtë se ekspozimi nuk sillte ndonjë problem të veçantë. Ekspozimi i përsëritur i punetoreve karshi fushave elektromagnetike nuk krijonte asnjë shqetësim klinik dhe as modifikim të laborëve para-klinike dhe biologjike. Në vitin 1999 studiuesit ruse dhe amerikane publikuan rezultatet përfundimtare të ndjekjes së rregullt të specialisteve (montatorëve të ndryshëm dhe stytë që punojnë për shfrytëzimin e linjave dhe nënstacioneve të tensionit të lartë mbi 110 kV) të ekspozuar gjatë punës së tyre ndaj një fushë elektrike intensive. Gjate një vëzhgimi 9-vjeçar (1990-1999), ekzaminimet klinike të përgjithshme dhe të specializuara, vunë në dukje së konstantet hematologjike e biokimike, LKG dhe LEG, testet biologjike të funksionimit të veshkave, të timideve, të mëlçisë, të organeve gjenetale etj. nuk patën ndryshime të ndjeshme për tu shqetësuar.

Vlerësuar identifikimeve të bëra është realizuar analiza e gjëndjes dhe e situatës që do zhvillohet në fuqat e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të hidrocentralit. Për minimizimin e ndikimeve në mjedis gjatë fazës ndërtuese dhe operuese të Hidrocentralit Dregu i Madh, duhet të implementohet Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM). Të gjitha punimet e ndërtimit duhet të realizohen në përputhje me këtë PMM. Masat lehtësuese të kërkuara për reduktimin e ndikimeve të cështjeve mjedisore të ndryshme inkorporohen me PMM të detajuar si më poshtë:

### Studimi Ndërkombëtar në Lidhje me Ndikimin e Fushës Elektrike e Magnetike (1999)

Ky studim me përfundimet e vëra është realizuar nga një grup shkencorësh të sektorit elektrik, mjedisor dhe mjekës dhe ka treguar limitet e rekomanduara në harrë të dhenave shëndetsore imediate të prapshme dhe të parashikuara, që mund të prodhohen nën efektin e ekspozimit në keto fusha. Kriteri bazë i analizës i përdorur nga ky grup shkencorësh është mekanizmi kryesor i hashkeveprimit me organizmin, duke paratur pasqyrën se dukuritë biologjike janëtribute të rrymave endogjene. Në këtë kuptim në funksion të detedues së rrymës, të marrim në disa diapazone të gjera, vihen në dukje dukuritë biologjike të renditura si vijon:



- Kur dendësia e rrymes në organizem është në kufijtë  $\delta = (1-10) \text{ mA/m}^2$ , nuk kemi probleme shëndetësore, dendësitet e rrymave janë në pragun e perceptimit të tyre.
- Kur dendësia e rrymes në organizem është në kufijtë  $\delta = (10-100) \text{ mA/m}^2$ , vihen në dukje dukuri të çarta që kanë të bëjnë me sistemin viziv dhe sistemin nervor qendror.
- Kur dendësia e rrymes në organizem është në kufijtë  $\delta = (100-1000) \text{ mA/m}^2$ , veshçen dukuri të çarta të stimulimit të indeve të eksitueshme e janë të mundura pasojat shëndetësore.
- Kur dendësia e rrymes në organizem është më e madhe se kufiri  $\delta = 1000 \text{ mA/m}^2$  mund të vihen të akstrasistola dhe fibrilacione ventrikulare.

Duke marrë një faktor sigurie 10 here, norma të vendeve të ndryshme kanë marrë si norme kufizimin e densitetit të rrymes në kufijtë  $\delta = 10 \text{ mA/m}^2$  për rrymat e induktuara.

### **Identifikimi i fushes elektromagnetike të linjës që lidh HEC-it Bregu i Madh dhe nenstacionit së bashku me infrastrukturën përkatëse.**

Mbeshtetur në metodiken e llogaritjes (sipas literaturës teknike universitare) për llogaritjen e intensitetit të fushës elektrike dhe magnetike përdoren inicialet e mëposhtme:

- Komponentja vertikale E e fushës elektrike e krijuar nga linja e tensionit të lartë në tokë.
- Komponentja horizontale B fushës magnetike e krijuar nga linja e tensionit të lartë në të njëjtën sipërfaqe të tokës. Formula llogaritëse e E është tërësisht duale me atë të B. Për të patur një ide për shpërndarjen e fushës elektrike të linjave të tensionit të lartë më poshtë janë nxjerrë nga literatura teknike bashkohore disa shembuj, dhe shembulli i parë i referohet linjave të tensionit të lartë në Francë.

Në vazhdim janë llogaritur dhe janë dhënë shpërndarjet përkatëse të fushës elektrike dhe magnetike sipas largësisë x nga shtylla gjatë pingule, si dhe e njëjta në largësinë o linjës ku kemi uljen më të madhe të saj. Në rastin e parë vihet re se vlera maksimale e fushës elektrike është në largësinë gati 2-6 m nga aksi i shtyllës, në mënyrë që vlera minimale gati 0.5 kV/m dhe vlera minimale gati 0.01 kV/m, në largësinë 15-16 m. Ndërsa për fushën magnetike vihet re se vlera maksimale e asaj arrin në 0.82  $\mu\text{T}$ , në largësinë përseri gati 2-6m nga aksi i shtyllës dhe vlerën minimale gati 0.012  $\mu\text{T}$ , e arrin përseri në largësinë gati 15-16m nga aksi i shtyllës. Në rastin e dytë, në mesin e gjatësisë së linjës ku kemi uljen më të madhe të përcjellësve, vijne në konsiderim grafike, në vazhdim në vlerat maksimale të fushës elektrike dhe magnetike përkatësisht 0.82 kV/m dhe 1.42  $\mu\text{T}$ .

Perfundimi i arritur për normat e mesiperm është se nën dritën e rregullësive të shteteve sipër, fushat elektromagnetike të linjave të tensionit më të cilin do të lidhen HEC-i Bregu i Madh, me nenstacionin përkatës (tensionit 110 kV) janë të paktën larg dhe shumë larg (poshtë) limiteve të rekomanduara më sipër, pra nuk kemi të bëjmë me shqetësime shëndetësore. Kjo është gjithashtu e vertetë për linjen e tensionit të ulët 10 kV që do të lidhi HEC-i që do të ndërtohet me nenstacionin.



## Standartet dhe Rekomandimet Nderkombetare

Ne themel te hartimit te standarteve eshte pasur parasysh uje studim i fondesishem i kryer nga Organizata Boterore e Shendetesise per mbrojtjen nga rrezatimet dhe i rekomanduara te perdoret per mbrojtjen nga fushat elektromagnetike, ne vitin 2000 dhe perfundimet e tij po shfrytezohen nga mjaftte institute kerkimore shqerore te pavaruara te shumte vendeve te botes. Disa nga keto standarte dhe rekomandime jane:

- Duke parur parasysh problemin e rrymave tudogjone pike referimi e ndertimit te normes eshte marre deqdesia e rrymes se induktuar prej 10 mA/m<sup>2</sup>, pra kjo eshte norma baze referuese.
- Kjo rryme ka ne korrespondence ekspozimin e njeriut ne fusha elektrike me gradient 25 kV/m dhe fushen magnetike me induksion 5 mT, te frekuences 50 Hz.
- Organizata Boterore e Shendetesise dhe shumte institute te tjera shendetesore shqeterore e kane konsideruar te pershtatshme, ce ne funksion te kujdesit qe duhet te treguar ne varesi te ekspozimit, te kohезgjarjes se tij etj. te rekomandoje kufij me te gjere (per ekspozime me te shkurtra ne koke) ose me te ngushta (per ekspozime te gjata).
- Perfundimi i arritur per normal e mesiperm eshte se nen driten e treguesve te sjelle me sipër, fushat elektromagnetike te linjave te tensionit te larte (110, 220, 400 kV si dhe nenstacionet (400/220/110 kV) te njeiti transmetues jane shumte larg (dhe poshte) limiteve te rekomanduara me sipër, pra nuk kemi te bejme me shqetesime shendetesore.

Vleresuar identifikimeve te bera eshte realizuar analiza e gjendjes dhe e situates qe do zhvillohet ne fazat e ndertimit dhe te shfrytezimit te hidrocentralit.

Per minimizimin e ndikimeve ne mjedis gjate fazes ndertuese dhe operuese te Hidrocentralit Bregu i Madh duhet te implementohet Plani e Menaxhimit Mjedisor (PMM).

Te gjitha punimet e ndertimit duhet te realizohen ne perputhje me kete PMM.


Masat lehtesuese te kerkuara per reduktimin e ndikimeve te oeshrjeve mjedisore te ndryshme inkorporohen me PMM te detajuar si me poshte:

### 7.3 Ndikimet ne mjedis gjate ndertimit te veprave te marries se ujit dhe godines se Hec-it.

Per ndertimin e ketij hidrocentrali do te ndertohen keto veprat do te realizohen gerrime per veprat e marries, rehabilitimit te kanalit te bujqesise ekzistues, shtrimit te tubacioneve, perdorim te makinerive gerruese dhe transportuese, etj. Pra gjate kryerjes se ketyre operacioneve do te kete krijim te pluhurave ne sasira te vogla si rezultat i punimeve te ndryshme qe duhen bere per realizimin e objektit.

### 7.4 Ndikimet ne mjedis gjate pregtitjes se veprave te marries dhe derivacionit per ne Hec-it

Nje ndikim ne mjedis ka edhe pregtitja e veprave hidroteknike te ketij objekti. Per shkak te punimeve te gerrimit do te kemi emertim pluhuri ne sasira te vogla si rezultat i punimeve te ndryshme qe duhet te behen. Per te bere te mundur reduktimin ne minimum te pluhurave gjate transportit eshte e domosdoshme qe makina transportuese te lagen dhe te mbulohen.



### 7.5 Ndikimet ne mjedis gjate largimit te materialeve qe do te largohen nga kanalet, linjat e shtrirjes se tubacioneve, etj

Terreni ma ior e kodrinor neper te cilin do te kalojne kanalet dhe tubacionet e dergimit te ujit per ne hidrocentral, tregon se nuk kemi te bejme me shume gerrime. Pjesa me e madhe e materialeve te gerrimit eshte nevoja te largohen nga kanalet, dhe pjesa tjetër do te perdoret per te sistemuar dhe mbushur terrenin perreth kanaleve. Megjithate nje sasi e vogel dhen i gerruar do te largohet nga sheshi dhe duhet te depozitohet ne vende te caktuara. Pikerisht pashteti lokal duhet te caktojte vendin e pershtarshem ku do te depozitohen pa shkaktrim ndoje te tjera ne mjedis.

### 7.6 Ndikimet ne mjedis si rezultat i sjelljes se materialeve te ndryshme per ndertimin e veprave hidroteknike te hidrocentralit.

Megjithese kemi te bejme me hapje kanalesh te permasave te vogla (luellesia max 1.0 m), nuk do te kemi volume te konsiderueshme materialesh ndertimi (rreze, cakull, beton, tuba, etj) qe do te sillen per betonimin nepermjet makinave te tomazilut te mesem dhe te vogel sipas rasis. Te gjitha keto makina do te rrisin trafikun dhe nivelin zhurmave ne zone gjate peridhës se ndertimit.

### 7.7 Vleresimi i efektivitetit te priteshem te masave zbutese

Realizimi i objektivave dhe treguesve te priteshem te parashikuara ne projektin e ndertimit te Hidrocentralit Bregu i Madh, do te varet nga respektimi i treguesve te percaktuar. Kontrolli i monitorimit dhe perrmesimi i vazhdueshem, sipas kushteve te shfrytezimit te krijuar gjate aktivitetit, do te çojte perfundimisht ne perfundimin e punjeve te parashikuara ne projekt.

### 7.7 Zhurmat

Gjate ndertimit te Hidrocentralit Bregu i Madh, do te kete angazhim te makinerive per punime gerrimi, transporti materialesh, etj. Per te zbutur efektin e trafikut te ngarkuar dhe zhurmave qe shoqerojne ato, me qellim uljen e shqetesimeve per popullaten perreth zones se ndertimit te hidrocentralit, si rruge te perkohshme do te perdoren ku te jete e mundur rruges dytesore. Projekti parashikon rruge ndihmese. Transportimi i materialeve te ndertimit ne rruges egzistuese do te programohet me kujdes per te shmanjur edo shqetesim ne trafikun lokal. Gjate nates, automjeter e ndertimit do te kerkohej qe te operojne me shpejtesi te ulta dhe do te ndalohet perdorimi i borive.

### 7.7 Ndikimet ne ujrat siperfaqesore

Zbatimi i ketij projekti nuk le shkak per ndotjen e ujerave rrjedhes siperfaqesore nga ndates te ndryshem si karburantet, lendet helmuese etj. Nuk pritet te ndodhe qofte dhe ndonje ndotje indirekte qe mund te rezultojne nga shkaktimet ne toke, e me pas te shplahen nga rreshjet, pasi ato nuk do te perdoren gjate zbatimit te projektit apo rehabilitimit te territorit, ndersa nga karburantet mund te kete vetem ndotje aksidentale nga rrjedhja e njeleve te punes.





## 7.8 Ndikimet ne ujrat nentokesore

Zbatimi i projektit nuk ndikon ne ujrat nentokesore pasi ai shfrytëzon ujërat sipërfaqësor dhe kalon ne sipatet e malit larg zones se influences se tyre në brendësi të tokës. Projekti nuk parashikon hapje rrucesh që mund të ndërpresin fluksat e levizjes së burimeve nëntokesore.

## 8. PLANI I ZBUTJES SE NDIKIMEVE NEGATIVE DHE REHABILITIMET

### 8.1 Përdorimi tokes

Ndërtimi i veprave hidroteknike te Hidrocentralit Bregu i Madh, nuk krijon shqetesim domethënës per komunitetin perreth, si gjate fazes se ndertimit aslta dhe ne fazen e shfrytëzimit. Punimet e ndertimit do te vazhdojne per nje perincje te vogel kohe dhe nuk do te krijohen demtime domethenese te tokes. Nuk ka mbetje demtuese ne sipërfaqen ku do te vendosen veprat e marjes se ujit, ku du te hapen kanalet derivacionit dhe tubacionine presionit. Per duhet te theksojme qe permasat e ketyre kanaleve jane te vogjel me nje gjeresi max 1.5 m dhe thellesi rreth 1.0 m, te cilet nuk duken nga larg dhe nga zonat e banuara, por vetem nga kalimtarët qe kalojne aty afer.

Per sa i perket ndertimit te nderteses se Hidrocentralit Bregu i Madh, ajo nuk do te vendoset ne toke buke, por ne toke djerre anës përroit. Vepra e marjes do te parashikojë funksionimin e rrjedhjes së ujit ekologjik. Duhet te theksojme edhe njehere se te gjithë nenobjektet e Hidrocentralit Bregu i Madh duke filluar nga vepra e marjes, kanalet e derivacionit, baseni presionit, tubacioni i turbinave dhe ndertesat hidrocenralit nuk vendosen ne toke buke, por ne sipate mali dhe lugine lumi ne kufi me ato pak fushtat buke qe jane.

### 8.2 Ndikimi tek njerëzit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu.

#### 8.2.1 Ndikimi ne popullsi

Ndërtimi i Hidrocentralit Bregu i Madh, në këtë zonë nuk ka për të sjellë probleme për komunitetin e kësaj zone. Realizimi i këtij projekti, duke mos patur nevojë për krijimin e një rezervuari, nuk do të shkaktojë ndryshime në popullsinë e saj, apo zhvendosje të saj për shkak të këtij aktiviteti.

Ndërkohë duhet të theksojmë që ndërtimi i Hidrocentralit Bregu i Madh, do të këtë avantazhe të mëdha, jo vetëm për biznesin, por dhe për turizmin e kësaj zone. Planet në perspektivë për shtrirjen që do të ketë zona në një të ardhme të afërt, kjo e bazuar dhe në studimin urbanistik zonal të miratuar, si dhe vetë situata e vështirë energjetike që po kalon vendi ynë e rajoni në përgjithësi, flasin për domosdoshmërinë e fillimit sa më shpejt të këtij projekti. Ndërkohë duhet theksuar dhe fakti që në këtë aktivitet mendohen të punësohen një numër i konsiderueshem punonjesisht duke zbutur sado pak plagën e papunësisë dhe atë të emigracionit.

#### 8.2.2 Ndikimet ne peisazh

Kemi theksuar se karakteristike e Hidrocentralit Bregu i Madh, eshte ruajtja dhe mos ndryshimi i peisazhit dhe mjedisit te saj, prandaj pejsazhi nuk ka per te patur asnje demtim domethënës dhe do te ketë nevojë per



rigjenerim per periudhen e shfrytezimit te HFC-it per sipërfaqet ku janë kryer germime. Pas një ose dy vitesh nga rehabilitimi paisazhi do të kthehet në gjendjen fillestare.

### 8.3 Ndikimet e hidrocentralit mbi trashëgiminë arkitektike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra te tjera njerëzore

Si rezultat i ndërtimit të Hidrocentralit Bregu i Madh në këtë zonë, nuk ka dhe nuk do të ketë ndikime negative mbi trashëgiminë arkitektike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerëzore, sepse në zonë dhe përreth saj, ka objekte te rëndësise arkitektike por ndodhet në distance të largët nga ky i fundit dhe nuk ka të drejtëpërdrejtë.

### 8.4 Ujja e intensitetit të erozionit dhe zbutja e ndryshimeve të topografisë.

Qëllimi i projektit lidhet me ndërtimin e Hidrocentralit Bregu i Madh, për prodhimin e energjisë elektrike. Ndër objektivat themelore të këtij aktiviteti është prodhimi i energjisë elektrike ndërkohë që mungesa e saj po krijon shumë probleme në Shqipëri edhe në rajon.

Për të ruajtur ekuilibrin mjedisor du të merren këto masa:

- Mirëmbajtja e veprave hidroteknike, kanaleve të sjelljes së ujit si dhe ndertesës së centralit për mos lejimin e përmblytjeve nga rrjedha ujore dhe prurjet e ngurta në raste të shirave të rrembyeshëm dhe stuhirave të paparishkuara.
- Në raste të tilla ose në rast avarish do të bëhet derdhja direkt në lumë, tubacioni i të cilit është në ato përmasa që të marrë të gjithë sasinë e ujit. Por në rast avarish të mëdha pritjet janë realizuar me porta që hapen e mbyllen sipas kërkesave që bëjnë menjëherë bllokimin e hyrjes në kanal.
- Mbjelljen e menjëhershme, me mullërim, e gjithë sipërfaqeve sidomos në të dy anët e kanalit, e cila është edhe zona që mund të sjellë ndonjë problem për erozion. Mbjellja e pemëve ka një rol të rëndësishëm, se duhet paratur parasysh mezikua aktual i erozionit i cili shprehet me kombinimin e indeksit të Rrezikut Potencial të Erozionit (indeksi erodibilitetit x indeksin e erozionit x indeksin e përrësise) dhe indeksin e vegjacionit (shkalla e mbuleses himore).

## 9. NDIKIMET NE FLORE, FAUNE DHE GJEOLGJINE

### 9.1 Bimet e ujit

Në zonën ku do të merret uji nuk ka bime uji, për vete morfologjine që ka përroi dhe për karakterin abraziv të tij në zonën ku do të merret uji po kështu edhe në zonën ku do të ndërtohet ndërtesa e centralit. Nga ky aktivitet nuk do të ketë dëmtime të tyre.

### 9.2 Flora dhe Fauna

Zona sic është përshkruar edhe më lart, nuk është e mbushur me bimësi, pasi kanalet janë ekzistues dhe do të rridimensionohen e për pasojë nuk dëmtojnë asgjë. Fauna e zonës, sidomos ajo ujore, nuk pëson ndonjë ndryshim të ndjeshëm nga ky projekt. Pjesa e përroit në rrjedhën e poshtërme mbas ndërtimit të Hidrocentralit Bregu i Madh, nuk konsiderohet e mbushur me peshq. Aktiviteti i ndërtimit e shfrytezimit nuk sjell influence negative në



tolenizim, shumëzim, etj. Gjate fazës së shfrytëzimit nuk ka elemente të shqetesimit per demtimin e faunes. Po ashtu edhe fauna karakteristike e zonës është e paprekshme nga ndikimet e ndërtimit te ketyre kanaleve, pritave, per arsye se aktiviteti i ndërtimit dhe shfrytëzimit nuk demton as ne floje e as ne numer elementet e floras dhe faunes, si pjese perberese e ketij rajoni. Pra, si perfundim theksojme se ndërtimi i Hidrocentralit Bregu i Madh, dhe shfrytëzimi i tij nuk e demton floran dhe faunen e kesaj zone. Ndërtimi i Hidrocentralit, do jete nje ndihme e madhe per kete zone per vete kushtet per kerkesa te madhe per energji elektrike qe po kalon vendi yne dhe rajoni.

### 9.3 Humbja dhe demtimi i tipareve gjologjike, paleontologjike, problemi i mjedisit gjeologjik

Ne pikoparje te struktures gjeologjike dhe pamjes se relievit, kjo zone nuk ka vecari lipike dalluese dhe nuk ka asnje arsye te vleresohet ose te merret parasysh gjate ketij aktiviteti. Kjo zone perben nje pejsazh te zakonshem gjeologjiko-gjeomorfologjik, karakteristike e ketij rajoni.

## 10. NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDISIN PERRETH

### 10.1 Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografisë së zonës, tokës, etj.

Gjate te ndërtimit të Hidrocentralit Bregu i Madh, dhe të projekteve përkatëse të tij, do të ketë ndryshime polnuajse të papërfilleshme të topografisë lokale. Në projektet e tij janë parashkuar një radhë ndërhyrjesh që, në kombinim me masat e tjera suplementare të sistemit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin e mundshëm. Gjate ndërtimit të kanaleve dhe tubacioneve nuk pritet të ketë ndryshime në topografinë lokale. Në projekt është parashkuar një radhë pune dhe drejtim i tillë, që në kombinim me masat e tjera suplementare të mbushjes, sistemit dhe trajtimit, të parandalojnë fenomenin e erozionit:

- Ndikimet në përdorimin e tokes dhe të burimeve.
- Në cilësinë dhe sasinë e tokes arë.

Sipërfaqja që do të përdoret për kalimin e kanaleve dhe të tubacioneve të Hidrocentralit Bregu i Madh, është kryesisht shpërruese e shpatit të maleve të krahut të djathtë. Pra nuk kemi të bëjmë me shumë toke bujqësore. Ndërtimi i këtyre veprave hidroteknike dhe i godinës së hidrocentralit në këtë zonë, nuk ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e tokes arë përkundrazi siguron dhe garantin sasinë e ujit të nevojshum për ujëte. Në zonën e ndërtimit të veprave hidroteknike, hap pas hapi është parashkuar sistemi i terretit dhe si pasojë zhvillimi i himësisë spontane të mëparshme të kësaj zone.

### 10.2 Ndikimet e projektit në modelin drenazhuar të zonës

Siç është theksuar më sipër, vepra që do të ndërtohet do të jetë e kombinuar dhe me funksionet e mëparshme dhe të perspektivës lidhur me mundësinë e përdorimit të përtut dhe për qëllime ujëte, ujëte dhe nevoja të zonës përreth. Për pasojë është i domosdoshëm që të rruhet sistemi i drenazhimit dhe kjo gjë do të bëjë në evitimin e ndryshimeve jo shumë të rëndësishme të sistemit të ujrave sipërfaqësore.



### 10.3 Në cilësinë dhe sasinë e tokës

Sipërfaqja në të cilën do të ndërtohet Hidrocentrali i Bregu i Madh, (veprat e marrjes, kanalet e derivacionit, baseni presionit, tubacionin e turbinave dhe ndërtesa e centralit) nuk është tokë bujqësore. Ndërtimi i këtij hidrocentrali nuk përbën asnjë problem për sa i përket cilësisë së saj.

### 10.4 Ndikimet në ujë

Ndërtimi i Hidrocentralit Bregu i Madh, nuk sjell asnjë problem në sasinë e marrjes së ujit në këtë burim për komunitetin, pasi është matur prarja për çdo muaj dhe për 12 muajt e vitit. Në çdo kohë do plotësohen nevojat e komunitetit për ujë të pijshëm, vadije pasi kanë ujët që mori nga përroi është rabi godimën e hidrocentralit ( Reforuar dhe lejes se përdorimit të ujit nga baseni ujëmbledhës Seman) dhe çdo aktivitet tjetër që kërkon përdorimin e ujit për prioritetet e mesipërme. Projekti nuk do të ndikojë negativisht në ujrat sipërfaqësore që përdoren nga komuniteti i afër, përkundrazi do të zgjidhe problemet e ujit gjatë sezonit të ujitjes të kulturave bujqësore pasi ai e mbledh ujin në dalje dhe siguron transportin e tij deri në godinën e centralit. Uji për ujitje në perputhje me Vendimin e Basenit Ujëmbledhës Seman do të japë ujë përgjatë gjithë kanalit, tokave bujqësore gjatë periudhës së ujitjes. Zbatimi i projektit nuk do të ndikojë negativisht në ujrat sipërfaqësore, pasi nuk do të krijohen hasene ete mëcha për rregullimin e rregjimit të prarjeve dhe përroi që nuk do të thahet dhe të krijojë probleme me shkratim e tij.

### 10.5 Ndikimet e ndotësve dhe mbetjeve në cilësinë e ujit

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikim në cilësinë e ujit, si nga veprat e marrjes, kanalet e sjelljes e deri në futjen në turbinë dhe daljeën e tij.

### 10.6 Ndikimet në ajër

Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk ka ndikim në cilësinë e ajrit të zonës, mbasi gjatë shfrytëzimit, nuk do të ketë emetime të gazrave dhe pluhurave.

### 10.7 Ndikimi në klimë

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk ka ndikim në klimën e kësaj zone.

### 10.8 Aromat sulmuese

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk ka emetime të aromave të ndryshme të çdo lloji qoftshin ato.

### 10.9 Ndikime të tjera klimatike

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk priten ndryshime të dukshme klimatike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj.





#### 10.10 Ndikime të tjera indirekte dhe sekondare, që shoqërojnë projektin

Projektet e tjera si p.sh. rrugët e reja, kanalele e ujtrave të zeza, hanosat, linjat e energjisë, komunikacionet, etj. nuk do të ndikojnë në realizimin e këtij projekti, pasi në zonën që prek ky projekt nuk ka elemente të infrastruktures si ato përmendën më lart.

#### 10.11 Ndikimet shoqëruese të projektit me projekte të tjera ekzistuese ose të propozuara

Ushtrimi i këtij aktiviteti do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e infrastruktures rrugore, turistike si dhe në ngritjen e nivelit socia-ekonomik në përgjithësi të fshatit Zaloshnjë dhe qytetit të Skraparit.

### 11. MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

#### 11.1 Organizimi

Hidrocentrali Bregu i Madh, do të jetë nën administrimin e shoqërisë "IIP ZALOSH NJA ENERGY" Sh.p.k. dhe do të ketë një administrator, drejtues teknik, specialiste, punëtorë mirëmbajtje të linjave të marrjes së ujit, shofërë roje të Lëtyre objekteve etj. Në hidrocentral do të punohet me tre turne, ndërsa maunjt e verës do të ketë ndërprerje ose reduktim të prodhimit të energjisë për mungesë të prurjeve dhe për realizimin e remonteve.

#### 11.2 Masat e sigurimit teknik në punë

Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve që do të punojnë në ndërtimin dhe shfrytëzimin e Hidrocentralit Bregu i Madh, do të realizohet duke zbatuar rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë.

Gjatë ndërtimit të veprës së marrjes, të hapjes së kanaleve të derivacionit mbi kanalele ekz të bujqësisë dhe ndërtimin e centralit, duhet të jenë në qëndër të vëmendjes problemet e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë, pasi këto janë më të rëndësishmet dhe që kërkojnë një vlerësim shumë serioz nga ana e drejtuesit të punimeve.

- Para se gjithash në të gjithë operacionet duhet të punësohen specialiste me eksperiencë pune në këtë fushë.
- Drejtuesi Teknik i punimeve duhet të bëjë instruktimin teknik të punonjësve, sipas kërkesave të rregullorës për këto punime.
- Në mjediset që do të punohet do të jetë gjithmonë kutia e ndalimit së shpejtë, dhe të jetë e mbyllur me kyç dhe të mbahet nga një punonjës që do të jetë gjithmonë i gatshëm.
- Punëtorët që do të punojnë për hapjen e traseve duhet të jenë të pajisur nga firma me të gjitha mjetet mbrojtëse si kapete plastike, mbrojtje, dorashka, këpucë etj.
- Një kaxhësi i vecantë duhet treguar edhe gjatë ndërtimit të hidrocentralit, duke zbatuar me korrektësi projektin e zbatimit të themeleve dhe të ndërtesës në përgjithësi.
- Për rastet e mundshme të rënies së rjarrit, në objekt duhet të jenë të vendosura shuarësit me gaz shkumues. Punonjësit e hidrocentralit duhet të jenë të instruktuar për rastet e rënies së rjarrit dhe për rastet e aksidenteve në punë. Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve që do punojnë në Hidrocentralin Bregu i Madh, do të realizohet duke zbatuar:
- Rregulloren e sigurimit teknik për punimet me tensione të larta,
- Normativat e ndotësve në mjediset e punës të miratuara nga Inspektorati i Higjencës së Punës,



- Garancinë e lëndëve të para si të padëmshme për shëndetin e puntorëve në të gjitha fazat e punës me to.

Operacionet e punës në mjediset hidrocentrale kërkojnë përdorimin e veshjeve personale speciale për të realizuar mbrojtjen nga tensionet e rrymës elektrike dhe të zhurmave. Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë do të jenë dy detyrat kryesore të stafit drejtues të hidrocentralit dhe i punonjësve.

Një ndër kërkesat e Shoqërisë "HP ZALOSHINJA ENERGY" Sh.p.k. për makineritë e blera dhe projektuesit e hidrocentralit, është që rreziku i aksidenteve në punë dhe prekja e shëndetit nga agjentet e ndryshëm fizike apo kimike të jetë sa më e vogël. Kjo do të bëjë të mundur që të ulen në minimum pasqjat që vijnë nga proceset e ndryshme të punës.

### 11.3 Mbrojtja e mjedisit

Hidrocentrali do të zhvillohet në harmoni me vlerat e natyrës. Brigjet dhe shpatet e maleve në zonë përbëjnë habitate potenciale për biodiversitetin e pasur që mbartin. Ndërtimi i veprave hidroteknike kërkon realizimin e shumë punimeve dhe ndërtimit e disa veprave (vepër marrje, kanale të marrjes së ujit, shtrim tubacionesh, ndërtim pllatash, ndërtim godine të turbinave, etj).

Vëmendje kryesore gjatë këtyre punimeve duhet të tregohet në dy aspekte,

- 1) sisteminimi i materialit inert të krijuar nga këto punime,
- 2) sisteminimi i brigjeve dhe shpateve për të evituar fillimin e erozionit.

Studimi i hollësishëm i strukturave gjeologjike, qëndrueshmërisë së tyre dhe masave të propozuarat nga projektuesit e këtij hidrocentrali janë garanci që këto probleme mjedisore do të jenë minimale.

Pra mund të themi se nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngeta apo të ngurta.
- Nuk ka shkarkime në ajër të gazrave apo tymrave.
- Zhurmat në mjediset e punës do të jenë brenda normës së cilësare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth.
- Nuk ka çlirim të sromave të ndryshme, etj
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës.
- Janë parashikuar marrja e të gjitha masave për mbrojtjen në punë dhe masat për evitimin e rrezikut të zjarrit.

Shoqëria "HP ZALOSHINJA ENERGY" sh.p.k ka mjetet e nevojshme teknike dhe financiare për të zhvilluar këto aktivitetet dhe kërkon të jetë e pajisur me të gjitha lejet përkatëse, sipas legjislacionit shqiptar.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e Hidrocentralit Bregu i Madh është përgatitur si pjesë e dokumentacionit që duhet për të marrë miratimet e zhvillimit të aktivitetit nga institucionet përkatëse.

Raporti është përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 8034 dt. 05.09.2002 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe Ligjit Nr. 8990, dt. 23.1.2003 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis". Ai synon të japë aspektet mjedisore të aktivitetit dhe ndikimet e mundshme në mjedis si rezultat i zhvillimit të tij.

Në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis Shoqëria "HP ZALOSHINJA ENERGY" Sh.p.k. jep informacionin eikutur:

- për aktivitetin që është menduar të kryhet në përputhje me kërkesat mjedisore.





- për zhvillimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë hidro që do të jetë në përputhje me kriteret për mbrojtjen e mjedisit.

#### 11.4 Masat e marra për zbutjen e rrezikut në mjedis dhe shëndet

Siq u theksua dhe më lart, mund të pohohet se rreziku në mjedis në zonën që do të realizohet projekti i ndërtimit të Hidrocentralit Bregu i Madh, është i minimizuar deri në arë shkallë sa mund të themi se nuk do të jetë prezent. Punime për ndërtimin e veprës së marrjes, kanaleve të derivacionit, objekti i godinës së turbinave, etj. do të jenë konform me cilësinë dhe standartet ndërkombëtare. Ndër masat e marra në rast zjarri, do të ndodhën të instaluarat impiantet e mbrojtjes kundër zjarrit. Për reagimin e mënjehershëm ndaj aksidenteve të mundshme humane do të ketë edhe një mjedis të mbyllur ku mbahet kuria e ndihmës së shpejte dhe do të vendosen mjete personale të punonjësve. Për uljen e rrezikut të aksidentimit të punonjësve nga mjetele e transportit gjatë fazës së ndërtimit, nuk do të lejohet të ecin me shpejtësi më shumë se 30 km/orë.

## 12. RREZIKU NE MJEDIS I LINJES SE TRANSMETIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE TE PRODHUAR DHE MASAT ZBUTESE TE TYRE

### 12.1 Ndikimet në mjedis gjatë fazës së operimit

Një nga efektet më të diskutueshme të një hidrocentrali dhe linjës të transmetimit të tensionit të lartë apo të mesëm, është efekti i fushave elektrike dhe magnetike në qeniet njerëzore dhe në mjedis në përgjithësi. Për këtë do të ndalemi në efektet e mundshme që mund të sjellin te njerëzit.

### 12.2 Rrymat Endogjene dhe Rrishti i Tyre

